



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË  
PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

NR. AKTI 14  
05.05.2020

NR. VENDIMI 30  
29.06.2020

**V E N D I M**

**"NË EMËR TË REPUBLIKËS"**

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korruptionin dhe Krimin e Organizuar, me trup gjykues të përbërë nga:

**K/Seance: Sander SIMONI**

E me sekretare séance, **Evloinda ADILI**, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore, në datë 29.06.2020, kërkesën penale nr. 14 regjistri themeltar, që i përket:

**KËRKUES:**

**IDENUARI:** O.T, i biri Kristos dhe i Zogës, i dtl. 29.09.1980, lindur në Tiranë dhe banues në Lushnjë, Lagjia "Clirimi", me shtetësi shqiptare, arsimi i lartë, i martuar, i padenuar më parë, i mbrojtur në gjykim me prokurë të posacme të lëshuar me datën 19 maj 2020 në një Zyrë Noteriale në Piacensa Itali, më Vulë apostile sipas konventës së Hagës 1961, nga av. Sokol Hazizaj, Anëtar i Dhomës së Avokatisë Tiranë.

**OBJEKTI :** Kthimin e shumës monetare sekuestruar sipas proces-verbalit "*Për sekuestrimin e provave materiale datë 31.05.2012*" të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.

**BAZË LIGJORE:** Nenet 217, 275 i K.Pr.Penale, neni 28 i Ligjit 10192 "*Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë*" i ndryshuar.

**NË PRANLTË :** Prokurorisë së Posacme kundër Korruptionit dhe Krimit të Organizuar, përfaqësuar nga prokurori **Edvin KONDILI**.

Gjykata pasi shqyrtoi kërkesën dhe dëgjoji përfundimisht kërkuesin që ishte për pranimin e saj si dhe Prokurorinë e Posacme kundër Korruptionit dhe Krimit të Organizuar që ishte

dakord me pranimin e kërkesës.

dhe pasi shqyrtoi provat në tërësi dhe e bisedoi çështjen në dhomën e këshillimit,

## **V Ë R E N:**

### **1. Rrethanat procedurale.**

Pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar në datë 05.05.2020 është rregjistruar kërkesa penale me nr.14 Akti me kërkues ( të dënuarin ) Orest Tabaku e me objekt: Kthimin e shumës monetare sekuestruar sipas proces-verbalit ‘ *Për sekuestrimin e provave materiale datë 31.05.2012* ‘ të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.

Kërkuesi Orest Tabaku me anë të prokurës së posaçme të datës 19 maj 2020, lëshuar para një zyre noteriale në Piacensa, Itali i ka dhënë tagër avokatit Sokol Hazizaj për paraqitjen e kërkesës në emër të tij para Gjykatës. Nga ana e gjykatës prokura u gjet në përputhje me Konventën e Hagës së vitit 1961, pasi ishte e pajisur me Vulë apostile.

### **2. Faktet ku bazohet kërkesa.**

Nga shqyrtimi gjyqësor i kërkesës rezultoi se :

Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda me vendimin nr.15 datë 01.02.2013 ka vendosur:

-Deklarimin fajtor të të pandehurit O.T, për veprën penale të ‘ *Trafikimit të narkotikëve* ‘ në bashkëpunim, mbetur në tentativë, të parashikuar nga neni 283/a/2-22 të K.Penal dhe dënimin e tij me 11 ( njëmbëdhjetë ) vjet burgim e në aplikim të gjykimit të shkurtuar është dënuar me 7 ( shtatë ) vjet e 4 ( katër ) muaj burgim.

Gjykata e Apelit për Krime të Rënda me vendimin nr. 34 datë 29.04.2013 ka vendosur lëniën në fuqi të vendimit nr.15 datë 01.02.2013 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.

Gjatë hetimit dhe gjykimit të çështjes penale për të cilën kërkuesi është gjykuar dhe dënuar , pra për shkak të veprës penale ka qënë dhe subjekt i Ligjit nr.10192 ‘ *Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë* ‘.

Për këtë arsye Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda , me vendimin nr.15 datë 24.07.2014, lidhur me gjykimin me objekt ‘ *Konfiskim pasurie* ‘ ndaj shtetasit O.T

ka vendosur:

- Pranimin e kërkesës duke konfiskuar pasuritë e mëposhtme të shtetasit O.T:
  - Shumën prej 10.490 Euro të depozituar në Bankën Intesa San Paolo me nr. llogarie XXXXXXXXXX.
  - Shumën prej 10.600 Lekë të depozituar në Bankën Raiffeisen me nr. llogarie XXXXXXXXXX.
- Për administrimin dhe përdorimin e llogarisë bankare ngarkohet Z.Kleant Xholi, i cili është administrator pranë Agjensisë për Administrimin e pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, pranë Ministrisë së Financave Tiranë.

Gjithashtu sipas mbrojtjes në përmbajtjen e këtij vendimi citohet se *‘ për ekzekutimin e këtij vendimi, në përputhje me nenin 14 të Ligjit 10192 datë 03.12.2009 urdhërohet Zyra e Përmbartimit Gjyqësor Tiranë, ndërsa për administrimin dhe përdorimin e llogarive bankare ngarkohet Z.Kleant Xholi, i cili është administrator pranë Agjensisë për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, pranë Ministrisë së Financave Tiranë’*.

Gjykata e Apelit për Krime të Rënda me vendimin nr.61 datë 29.09.2014 ka vendosur:

Ndryshimin e vendimit nr.15 datë 24.07.2014 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.

Rrëzimin e kërkesë/padisë , së Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.

Me vërtetimin nr.107/1 Prot datë 23.01.2020 kërkuesi dhe mbrojtësi i tij janë informuar se ndaj vendimit të sipërcituar nuk është bërë rekurs , duke u krijuar mundësinë ligjore të kthimit të shumës monetare të sekuestruar sipas proces-verbalit *‘Për sekuestrimin e provave materiale datë 31.05.2012’* në funksion të gjykimit për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 283/a/2 të K.Penal.

Mbrojtësi referuar vendimeve të sipërcituara si dhe detyrimit ligjor të parashikuar në ligjin nr.10192 *‘Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë’* i është drejtuar Agjensisë për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, të cilët me shkresën nr.41/1 Prot datë 03.03.2020 i kanë bërë me dije se rezulton se shuma në Euro është në llogarinë që i përket subjektit Prokuroria e Përgjithshme.

Mbrojtësi, duke konstatuar se prej organit procedural nuk është vepruar lidhur me ekzekutimin e vendimit nr.61 datë 29.09.2014 me të cilin është vendosur Ndryshimi i vendimit nr.15 datë 24.07.2014 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.

Rrëzimi i kërkesë/padisë , së Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, kërkon nga Gjykata e Posacme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar kthimin e shumës monetare sekuestruar sipas proces-verbalit *‘Për sekuestrimin e*

*provave materiale datë 31.05.2012*'' të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.

Nga ana e mbrojtësit në mbështetje të pretendimeve të tij u paraqitën si prova:

- Vendim nr.15 datë 01.02.2013 i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.
- Vendim nr.15 datë 24.07.2014 i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.
- Vendim nr.61 datë 29.09.2014 i Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda.
- Vërtetim nr.107/1 Prot datë 23.01.2020, sipas të cilit vërtetohet se nuk është ushtruar rekurs nga palët për vendimin nr.15 datë 24.07.2014 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda me objekt konfiskim pasurie ndaj shtetasit O.T.
- Shkresë nr.41/1 Prot datë 03.03.2020 e Agjensisë për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, sipas të cilës rezulton se shuma në Euro është në llogarinë që i përket subjektit Prokuroria e Përgjithshme.

Përfaqësuesi i Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar ishte dakort me pranimin e kërkesës duke mbajtur qëndrimin që paratë e sekuestruara duhen kthyer për kërkuesin, e kërkesa duhet pranuar.

### **3. Arsyetimi mbi bazueshmërinë e kërkesës.**

Kërkesa është bazuar në nenin 275 të KPrP sipas së cilit me vendimin e pafajësisë ose të pushimit të çështjes, gjykata ose prokurori urdhëron që sendet e sekuestruara ti kthehen atij që i takojnë, kur nuk duhet të urdhërohet konfiskimi i tyre sepse kanë shërbyer ose ishin të destinuara për të kryer një vepër penale ose sepse kanë qënë prodhim ose përfitim nga vepra penale.

Sic del nga provat e shqyrtuara në senacë gjyqësore shuma e parave të sekuestruara të dënuarit është sekuestruar në kuadër të procedimit penal ndaj tij sipas proces-verbalit ‘*Për sekuestrimin e provave materiale datë 31.05.2012* ‘ të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.

Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda me vendimin nr.15 datë 01.02.2013 ka vendosur:

-Deklarimin fajtor të të pandehurit O.T, për veprën penale të ‘*Trafikimit të narkotikëve* ‘ në bashkëpunim, mbetur në tentativë, të parashikuar nga neni 283/a/2-22 të K.Penal dhe dënimin e tij me 11 ( njëmbëdhjetë ) vjet burgim e në aplikim të gjykimit të shkurtuar është dënuar me 7 ( shtatë ) vjet e 4 ( katër ) muaj burgim.

Në këtë vendim gjykata nuk ka disponuar mbi provat materiale paratë e sekuestruara.

Gjykata e Apelit për Krime të Rënda me vendimin nr. 34 datë 29.04.2013 ka vendosur lëniën në fuqi të vendimit nr.15 datë 01.02.2013 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.

Gjatë hetimit dhe gjykimit të çështjes penale për të cilën kërkuesi është gjykuar dhe dënuar , pra për shkak të veprës penale ka qënë dhe subjekt i Ligjit nr.10192 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”.

Për këtë arsye Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda , me vendimin nr.15 datë 24.07.2014, lidhur me gjykimin me objekt ‘‘Konfiskim pasurie’’ ndaj shtetasit O.T ka vendosur:

- Pranimin e kërkesës duke konfiskuar pasuritë e mëposhtme të shtetasit O.T:
  - Shumën prej 10.490 Euro të depozituara në Bankën Intesa san Paolo me nr. llogarie XXXXXXXXXX.
  - Shumën prej 10.600 Lekë të depozituara në bankën Raiffeisen me nr. llogarie XXXXXXXXXX.

Gjithashtu sipas mbrojtjes në përmbajtjen e këtij vendimi citohet se ‘ *‘për ekzekutimin e këtij vendimi, në përputhje me nenin 14 të Ligjit 10192 datë 03.12.2009 urdhërohet Zyra e Përmbartimit Gjyqësor Tiranë, ndërsa për administrimin dhe përdorimin e llogarive bankare ngarkohet Z.Kleant Xholi, i cili është administrator pranë Agjensisë për Administrimin e pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, pranë Ministrisë së Financave Tiranë’’*.

Gjykata e Apelit për Krime të Rënda me vendimin nr. 61 datë 29.09.2014 ka vendosur: Ndryshimin e vendimit nr.15 datë 24.07.2014 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda. Rrezimin e kërkesë/padisë , së Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.

Me ndryshimin e vendimit nga ana e Gjykatës së Apelit dhe rrezimin e kërkesës për konfiskimin e parave të sekuestruara, ata janë kthyer në gjendjen e procedimit penal në gjendjen e sekuestrimit dhe në këtë rast prokuroria duhej të kishte vepruar sipas nenit 217 të KPrP duke ia kthyer ato të pandehurit.

Në këto kushte kërkesa e kërkuesit është e bazuar në ligj dhe e drejtë e si e tillë ajo duhet pranuar duke ia kthyer atij Shumën prej 10.490 Euro të depozituara në Bankën Intesa San Paolo me nr. llogarie XXXXXXXXXX si dhe shumën prej 10.600 Lekë të depozituara në Bankën Raiffeisen me nr. llogarie XXXXXXXXXX.

### **PËR KËTO ARSYE**

Gjykata, bazuar në nenin, 217 pag 3 dhe 218 pag 1 , 275 të KPrP,

### **VENDOSI:**

- Pranimin e kërkesës së kërkuesit (të denuarit ) O.T.

- Kthimin e shumës monetare të sekuestruar sipas proces-verbalit ‘*Për sekuestrimin e provave materiale datë 31.05.2012* ‘ të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, e me e konkretisht :
  - Shumën prej 10.490 Euro të depozituara në Bankën Intesa San Paolo me nr. llogarie XXXXXXXXXX.
  - Shumën prej 10.600 Lekë të depozituara në Bankën Raiffeisen me nr. llogarie XXXXXXXXXX.
  
- Për ekzekutimin e këtij vendimi ngarkohet Prokuroria e Posacme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar.
  
- Kundër këtij vendimi, lejohet ankim në Gjykatën e Posacme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 29.06.2020.

**SEKRETARE**

**Evloinda ADILI**

**GJYQTAR**

**SANDËR SIMONI**

